



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM
Nr. 46 datë 31.07.2024**

“PËR TRANSFERIMIN E FONDIT TË MBETUR GJENDJE NË LLOGARI JASHTË THESARI, PËR PROJEKTIN “NXITJA E PËRFSHIRJES SOCIALE DHE ZHVILLIMIT TË KOMUNITETIT” NGA LLOGARIA E DEDIKUAR E PROJEKTIT TEK TË ARDHURAT E BASHKISË SHKODËR DHE PËRDORIMIN E TIJ NË FUNKSION TË PROGRAMIT 07220 “SHËRBIMI I KUJDESIT PARËSOR SHËNDETËSOR”.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të dates 31.07.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 190 e udhëzimit Nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, VKM Nr.775 datë 24.09.2010 “Për administrimin e Financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimit Nr.35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, i ndryshuar, Udhëzimi plotësues i Ministrisë së Financave Nr 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024”, VKB Nr. 55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar”, si dhe kontratës së grantit me Nr. ref.: EU4M-CfP1-2022/A2, datë 23.06.2022 për të implementuar projektin “Nxitja e përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit”, financuar nga skema e granteve “BE Për

Bashkitë” në zbatim të buxhetit të miratuar sipas VKB Nr. 48, datë 27.09.2022 “Për Miratim shtesë plani në Buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB Nr. 3 datë 05.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë, Shkodër” i ndryshuar”, për realizimin e aktiviteteve të projektit, shkresës së dërguar nga Njësia e Mbështetjes Teknike për kthimin e fondeve tepricë mbas njohjes së shpenzimeve me nr. 9094, datë 30.04.2024; shkresës së dërguar nga Njësia e Mbështetjes Teknike me nr. 13970 Prot., datë 02.07.2024, Urdhërin për kthimin e tepricës së pashpenzuar për projektin me nr. 822, datë 05.06.2024, “Kthim përgjigje mbi përdorimin e fondeve tepricë”, raporti i dërguar në MF, shkresa me nr. 14117 Prot. datë 13.07.2024 për periudhën 01.01.2024 – 30.06.2024, si dhe pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e fondit të mbetur gjëndje në llogari jashtë thesari, për projektin “Nxitja e Përfshirjes Sociale dhe Zhvillimit të Komunitetit”, P09230.Q2.O1.A12, Rikonstruksioni i objektit të ish shkollës veterinarë (shtesë) nga llogaria e dedikuar e projektit tek të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe përdorimin e tij në funksion të programit 07220 “Shërbimi i kujdesit parësor shëndetësor”, sipas fishës bashkëlidhur.

Pakësim të trashëguara viti 2023

000/lekë

Nr	Nr. Programi	Programi	Aktiviteti/Emërtimi	Gjëndje në llog. jashtë thesari	Institucioni Likuidues
1	09230 (në llog. Jashtë thesari)	” Arsimi i mesëm i përgjithshëm”	P09230.Q2.O1.A12 Rikonstruksioni i objektit të ish shkollës veterinarë (shtesë) Projekti: “Nxitja e Përfshirjes Sociale dhe Zhvillimit të Komunitetit”,	1,593	Bashkia Shkodër
Totali				1,593	

Shtesë viti 2024

000/lekë

Nr	Nr. Programi	Programi	Aktiviteti/Emërtimi	Art. 602 Mallra dhe Shërbime	Institucioni Likuidues
1	07220 (Kap 6)	Shërbimet e kujdesit parësor	P07220.Q1.O1.A1 “Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor”- A.1 Mirëmbajtje e qendrave shëndetësore parësore. (shtesë)	1,593	Drejtoria e përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike
Totali				1,593	

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 01.08.2024



SEKRETARE

Sabina Danaj